POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Dokumenti/ Agron Shehaj e bleu 2.9 milionë euro vilën në Itali të cilën pas 4 vitesh e shiti 15 milionë euro. Tani ja “dyfishoi” sipërfaqen për të provuar të justifikojë çmimin
2 ‘Mos më fol si kryetar partie’, Xhafaj përplaset me Shabanin në Komisionin për Nismat Qytetare! Avokati i Popullit: Ky koment nuk ju nderon
3 Panik në ajër, fluturimi Londër–Tiranë i Ryanair zgjati 12 orë, stuhitë detyruan pilotin të bënte dy ulje emergjente, pasagjerët në revoltë
4 Botërori 2026/ Messi sot për herë të parë kundër 'Tre Luanëve', statistikat flasin për Anglinë! Argjentina i kujton 'Dorën e Zotit'
5 Blushi: Shpopullimi është krimi më i madh kombëtar i Ramës, Shqipëria po përjeton tragjedinë më të rëndë demografike në historinë e saj moderne

Kronikë

# Me armë në makinë e shtëpi, arrestohet 38-vjeçari në Vlorë! I sekuestrohen 2 pistoleta, granatë dhe 4 jelekë antiplumb (EMRI+VIDEO)

*Ermal Hamzo u ndalua në “Kthesën e Pilurit” në Himarë ku gjatë kontrollit në çantë, iu gjendën armët. Më pas, në kontrollin e shtëpisë së tij, u sekuestrua një pistoletë tjetër, krehra, municion luftarak, 2 jelekë antiplumb dhe 2 jelekë multifunksionalë. Hamzo rezulton me precedentë të mëparshëm kriminalë.*

Arrestohet 38-vjeçari në Vlorë! I sekuestrohen 2 pistoleta, granatë dh
Report TV
Watch on

Redaksia
9 Korrik, 13:01 | **Përditesimi: 9 Korrik, 13:21**
Share | Post

Një 38-vjeçar në Vlorë që qarkullonte me pistoletë e granatë në makinë, ka rënë në prangat e policisë. Ermal Hamzo u ndalua në “Kthesën e Pilurit” në Himarë ku gjatë kontrollit në çantë, iu gjendën armët.

Më pas, në kontrollin e shtëpisë së tij, u sekuestrua një pistoletë tjetër, krehra, municion luftarak, 2 jelekë antiplumb dhe 2 jelekë multifunksionalë.

Hamzo rezulton me precedentë të mëparshëm kriminalë.




LEXO EDHE:
**Dhunuan 70-vjeçarin në banesën e tij dhe e kërcënuan me pistoletë çakmak për ta grabitur, arrestohen tre të rinjtë në Himarë (EMRAT+ VIDEO)**

**Njoftimi**:

*DVP Vlorë/Finalizohet operacioni i koduar “Siguria 2”, për rritjen e parametrave të sigurisë dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale.*

*Sekuestrohen 2 armë zjarri pistoleta, 1 granatë, municion luftarak, 4 jelekë antiplumb/multifunksionalë, 1 automjet dhe 2 celularë.*

*Vihet në pranga 38-vjeçari i posedonte, shtetas me precedent penal për krime kundër personit.*

*Ai u kap në flagrancë nga Policia, në Himarë, duke qarkulluar me automjet, me pistoletë me fishek në fole dhe me granatë.*

*Si rezultat i kontrolleve të shtuara në territor, në kuadër të masave për rritjen e parametrave të sigurisë, parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, shërbimet e Komisariatit të Policisë Himarë, në bashkëpunim me shërbimet e Sektorit të Forcës së Posaçme “Shqiponja”, të DVP Vlorë, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan operacionin e koduar “Siguria 2”.*

*Në kuadër të këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi E. H., 38 vjeç, banues në Vlorë, me precedent të mëparshëm penal për krime kundër personit.*

*Ky shtetas u ndalua nga shërbimet e Policisë, ndërkohë që qarkullonte me automjet në zonën e quajtur “Kthesa e Pilurit”, Himarë. Pas ndalimit të automjetit, gjatë kontrollit në çantën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë me krehër të mbushur me fishekë dhe 1 granatë.*

*Në vijim, gjatë kontrollit në banesën e 38-vjeçarit, në Vlorë, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë, krehra, municion luftarak, 2 jelekë antiplumb dhe 2 jelekë multifunksionalë.*

*2 pistoletat, granata, krehrat, municioni luftarak dhe 4 jelekët antiplumb/multifunksionalë, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin dhe 2 celularë.*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit” dhe “Mbajtja pa të drejtë e uniformës”.*

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: ermal hamzo | Vlore | arme zjarri | arrestim

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 14 Korrik, 12:01
**Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare?**
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera


Gjuetia spektakolare, peshkatari në Vlorë fiton ‘përleshjen’ nën ujë, kap peshkun 27 kilogramësh (VIDEO)
15 Korrik, 12:17


Riaktvizohet vatra e zjarrit në Novoselë, tymi mbulon zonën (VIDEO)
15 Korrik, 08:59


Vlorë/ E përplasi makina, humb jetën 80-vjeçarja në Vranisht
14 Korrik, 22:45


Iu afruan pushuesve, gjobiten me 500 000 lekë dy drejtuesit e gomoneve në Vlorë! Bllokohen edhe mjetet lundruese (VIDEO)
14 Korrik, 16:29


Zjarr në Novoselë, digjen shkurre e barishte, rrezikohen banesat (VIDEO)
14 Korrik, 15:17


Përplasja në Zvërnec, Apeli lë në burg pronarin e kompanisë 'Major Security' dhe rojen private! Njëri në arrest shtëpie
Keti Banushi
14 Korrik, 14:32


Fluks në Pediatrinë e Vlorës: 90 fëmijë kërkojnë ndihmë në 24 orë! Mjekja: Mos i ekspozoni në diell
Armand Xhelili
14 Korrik, 13:50


Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI)
14 Korrik, 10:10


Zjarr në lagjen ‘15 Tetori’ në Vlorë, flakët përfshijnë një hapësirë me pisha e shkurre (VIDEO)
14 Korrik, 09:22


Rrezikuan të mbyteshin, Policia Kufitare u vjen në ndihmë 9 turistëve të huaj, në dy raste të ndryshme në Himarë e Ksamil (VIDEO)
13 Korrik, 19:31


Zjarr i madh në Llaman të Himarës, dyshohet i qëllimshëm! 5 zjarrfikëse në vendngjarje (VIDEO)
13 Korrik, 18:44


Ishte duke punuar, 44-vjeçari bien nga soleta e një objekti në Sarandë! Niset drejt Traumës (VIDEO)
Limos Didani
13 Korrik, 18:09







Lajmi i fundit

**Ministri Salla në Pogradec: Nisi procesi i rrallimit të rasateve të Koranit autokton në ekonominë e Linit**
15 Korrik, 16:33



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



Ministri Salla në Pogradec: Nisi procesi i rrallimit të rasateve të Koranit autokton në ekonominë e Linit

15 Korrik, 16:33

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com